VENDIM
Nr. 324, datë 16.5.2019

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2019, NDËRMJET MINISTRISË SË BRENDSHME DHE MINISTRISË SË MBROJTJES, PËR SHPËRBLIMIN E DISA PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", dhe të ligjit nr. 108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2019 të bëhet rishpërndarja e fondeve, ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Brendshme t'i shtohet fondi prej 170 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh, në programin buxhetor "Policia e Shtetit", për shpërblimin e punonjësve të Policisë së Shtetit, për rezultate të larta në kryerjen e detyrës;

b) Ministrisë së Mbrojtjes t'i pakësohet fondi prej 170 000 000 (njëqind e shtatëdhjetë milionë) lekësh, në zërin "Shpenzime korrente", të programit "Mbështetja e luftimit".

2. Masa e shpërblimit të jetë deri në një pagë mujore dhe lista e punonjësve të Policisë së Shtetit, që do të shpërblehen, të miratohet nga ministri i Brendshëm, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

`